



Prishtinë, 27.02.2026
Kodi i ZRRE-së: V_3084_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2802_12_25** i datës 03.12.2025;
- Ankesa e konsumatorit e dt. 05.01.2026.

në seancën e mbajtur më datë 27.02.2026 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **E. J.**, nga fsh. Makresh i Epërm, Komuna e Gjilanit, si e pabazuar.
- II. **MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK_V_2802_12_25 i datës 03.12.2025.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me datë 03.12.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2802_12_25 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit E. J., lidhur me kontestimin e faturimit me njehsorin elektrik me nr. 75482588 si dhe korrigjimit financiar me nr. 29299DGL – 9054481, i dt. 16.05.2025.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Ekipa e KEDS kanë qenë në vend të ngjarjes dhe kanë konstatuar se ora ka rrjedhur, pa pasur kyçje të pajisjeve;
- Ora është ndërruar, dhe se ora e vjetër ka qenë më defekt nga prodhuesi.
- Kërkon që të rishikohet faturimi në tërësi, me arsyetimin që konsumatori nuk është fajtor për mosfunksionimin e orës së KEDS.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Transaksionet e konsumatorit, Rrjedha e Energjisë Elektrike, Listat e Leximit, procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr.0752261 date 07.06.2021, procesverbalin e shqyrtimit nr.2034 date 07.04.2025 si dhe nr. 29299DGL-9054481 të datës 16.05.2025. Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Sipas transaksioneve të konsumatorit vërtetohet se me datë 19.03.2021 konsumatori është faturuar me shërbime për Lidhje të Re si dhe i është hapur shifra DGL 9054481. Bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike dhe analizimit të listave të leximit konstatohet se punëtorët e autorizuar të KEDS për leximin e pikave matëse kanë bërë inspektime të rregullta mujore dhe se konsumatori ka lexime dhe faturime të rregullta mujore. Bazuar në listat e leximit vërtetohet po ashtu se lexuesi i KEDS-it në asnjë rast nuk ka evidentuar çfarëdo çrregullime në njehsorin elektrik nr. 75482588.

Bordi më tej e ka analizuar procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr.0752261 date 07.06.2021 dhe konstaton se ekipet e KEDS-it kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 75482588 me gjendje të shpenzimeve TL=1739 kWh dhe TU=1212 kWh dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr.69073080 me gjendje të shpenzimeve TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal vërejtjen se: " Është ndërruar njehsori pasi është në defekt". Bazuar në vërejtjen e evidentuar, theksojmë se, KEDS nuk kanë përshkruar qartë defektin e njehsorit elektrik duke mos potencuar saktë se cili është defekti në njehsorë.

Me datë 07.04.2025 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë shqyrtimin e saktësisë së matjes për njehsorin elektrik nr. 75482588 me gjendje të shpenzimeve TL= 0001747 kWh dhe TU=0001212 kWh ku kanë evidentuar se: njehsori nuk është në rregull, dëmtime të jashtme nuk ka, njehsori elektrik mund të lexohet në mënyrë softwerike, bllokat shtetërore i ka, njehsori elektrik duhet të shkojë në asgjësim, njehsori elektrik mund të testohet etj.. Po ashtu në procesverbal është evidentuar vërejtja se gjatë testimit: **Njehsori elektrik orën dhe datën e ka gabim**, kurse është evidentuarës gabimi në matje është +0.03%. Bordi i ka shqyrtuar të dhënat e evidentuara në procesverbal dhe konstaton se gabimi i evidentuar i matjes për njehsorin elektrik nr. 75482588 është brenda kufijve të lejuar të gabimit të përcaktuar me Kodin e Matjes së OSSH-së e që është +-2.5%.

Bordi i ka shqyrtuar faturat kontestuese të konsumatorit dhe konstaton se faturimi për këtë periudhë është në kundërshtim me nenin 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji e ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar edhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.*

Bordi e ka shqyrtuar Korrigjimin Financiar plotësues nr. 29299DGL-9054481 të datës 16.05.2025, të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO në vlerë prej 6.29€, në të cilin është evidentuar si vijon: "Korrigjimi i kWh për periudhën 04/2021 deri 06/2021 pasi që njehsori ka pasur orën dhe datën gabim



bazuar ne procesin e shqyrtimit me nr.20341 i dt.07.04.2025 A1 =1747 kWh dhe A2=1212 kWh dhe rrjedha e energjisë. Konsumatorit ju ndahet shpenzim ne përqindje sipas njehsorit te ri A1=64% dhe A2=36%”, dhe ka gjetur se, ky korrigjim është i saktë dhe se KESCO ka vepruar konform me nenin 28 paragrafit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji e ku thuhet se: “Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”.

Tutje, duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, “*të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRrE-ja*”, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i pati në konsideratë edhe disa prova të tjera materiale si në shkresat e lëndës, por që të njëjtat nuk kanë pasur ndikim në vendosjen ndryshe lidhur me këtë rast.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova konkrete.

Bordi i ZRrE-së pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët e në veçanti Ligjin Nr. 05/L-081 për Energjinë, Metodologjinë e Taksave të Kyçjes së OSSH-së, Kodit të Shpërndarjes si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO;
- Konsumatorit E. J.,
- Arkivit të ZRRE-së